



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05/247  
19/07/2019  
Podujevë

Bazuar në nenet 7 dhe 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, Ligjit mbi Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nr. 04/L-032, Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, i datës 19.10.2017, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 10/2018 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, i datës 20/07/2018, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 05/2015, Normativ për mësimdhënësit e arsimit profesional, si dhe kërkesave e nevojave për plotësimin e vendeve të lira të punës për mësimdhënësit të shkollave fillore dhe të mesme të Komunës së Podujevës, Drejtoria e Arsimit shpall:

### KONKURS

#### Për mësimdhënësit në Komunën e Podujevës për vitin shkollor 2019/2020

1. **Nëntëmbëdhjetë (19) mësimdhënësit të programit fillor** (prej tyre 2 zëvendësim derisa të kthehen punëtorët nga pushimi i lindjes)
  - Kriteret e kualifikimit:
    - Fakulteti i Edukimit – Programi fillor;
    - Fakulteti i Mësuesisë.
2. **Tre (3) mësimdhënësit të gjuhës gjermane**
  - Kriteret e kualifikimit:
    - Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
    - Sistemi katërvjeçar;
    - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS);
    - Të gjithë të kualifikuarit në njësitë akademike që kanë përfunduar master arsimor me 300 ECTS, kanë të drejtë konkurrimi;
    - Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar të nivelit master arsimor, sistemit katërvjeçar dhe baçelor katërvjeçar, mund të pranohet niveli baçelor trevjeçar për një vit shkollor.
3. **Një (1) mësimdhënësit të edukatës figurative** (zëvendësim derisa të kthehet punëtorja nga pushimi i lindjes)
  - Kriteret e kualifikimit:
    - Programi – Pikturë; Skulpturë; Grafikë;
    - a) Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
    - b) Sistemi katërvjeçar;
    - c) Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS);
    - d) Të gjithë të kualifikuarit në njësitë akademike që kanë përfunduar master arsimor me 300 ECTS, kanë të drejtë konkurrimi;
    - e) Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar të nivelit master arsimor, sistemit katërvjeçar dhe baçelor katërvjeçar, mund të pranohet niveli baçelor trevjeçar për një vit shkollor.

4. **Një (1) mësimdhënës të matematikës në gjimnazin “Aleksandër Xhuvani” Podujevë** (zëvendësim derisa të kthehet punëtorja nga pushimi i lindjes)
- Kriteret e kualifikimit:
    - Niveli master arsimor – Fakulteti i Edukimit (300 ECTS);
    - Sistemi katërvjeçar;
    - Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS);
    - Të gjithë të kualifikuarit në njësitë akademike që kanë përfunduar master arsimor me 300 ECTS, kanë të drejtë konkurrimi;
    - Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar të nivelit master arsimor, sistemit katërvjeçar dhe baçelor katërvjeçar, mund të pranohet niveli baçelor trevjeçar për një vit shkollor.
5. **Tre (3) mësimdhënës të lëndëve të mjekësisë:**
- Dy (2) mjekë specialist/mjekë
  - Një (1) master të infermierisë dhe mamive

#### **KUSHTET:**

##### **I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:**

- Formulari i aplikimit (i cili merret dhe dorëzohet në qendrën për shërbime të qytetarëve, zyra nr. 14 e komunës);
- Certifikata e lindjes;
- Dokumentin personal – letërnjoftimi ose pasaporta (kopje);
- Dëshmi mbi kualifikimin (kopja e vërtetuar);
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT;
- Dëshmi mbi përvojën e punës (nëse keni);
- Certifikatën që nuk jeni në hetime;
- Certifikatën e mjekut (vetëm kandidatët të cilët pranohen në marrëdhënie pune, pra pas publikimit të rezultateve).
- **Sqarim shtesë:**
  - Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmohen me dokumente;
  - Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuara dokumentet në MASHT;
  - Në test/intervistë ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit sipas U. A. (MASHT) nr. 10/2018 për normativ mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, i datës 20/07/2018 dhe U. A. (MASHT) nr. 05/2015, Normativ për mësimdhënësit e arsimit profesional, por në mungesë të kuadrin adekuat mund të ftohen edhe kandidatët me kualifikim të përafërt;
  - Testi/intervista me kandidatë për mësimdhënës mbahet në SHFMU “Dr. Ibrahim Rugova” Podujevë, sipas orarit i cili do të publikohet më dt. 12/08/2019, në tabelën e shpalljeve të Komunës së Podujevës (në hyrje të objektit të komunës);
  - Me këtë konkurs zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor 2019-2020. Në rast të ndonjë nevojë eventuale për mësimdhënës/e në IEAA, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listave pritëse;
  - Dokumentet nuk kthehen.
- **Afati i konkursit**

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës dhe në ueb-faqen e Komunës së Podujevës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve>, pra deri më datë 03/08/2019.

Drejtori

Agim Blakçori

